VENDIM
Nr. 515, datë 18.7.2003

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të neneve 8 pika 3 dhe 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të pronave me numër rendor 9 dhe 10 (Klubi shumësportësh "Partizani"), 549 (Shtëpia e Ushtarakëve, Korçë) dhe 653 (Shtëpia e Ushtarakëve, Përmet), që me vendim të Këshillit të Ministrave, u kanë kaluar në administrim institucioneve të tjera.

Lista përfshin 1 117 (një mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) prona dhe përbëhet nga 765 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Mbrojtjes dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano